



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KABINETI

**NJOFTIM PËR SHTYP**

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të shoqërisë Unione di Banche Italiane S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksionin i cili synon përfitim të kontrollit të shoqërisë Unione di Banche Italiane S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.

Më datë 17 Shkurt 2020, është lëshuar “Ofertë Shkëmbimi Vullnetar”, nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A për të gjitha aksionet e zakonshme të shoqërisë Unione di Banche Italiane S.p.A.

Palët pjesëmarrëse:

**Pala blerëse:** Intesa Sanpaolo S.p.A është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionin Italian e cila e ka filluar aktivitetin bankar më datë 01.01.1998, shoqëri e regjistruar në regjistrin e shoqërive të Torinos. Intesa Sanpaolo S.p.A është shoqëria mëmë e Grupit Intesa Sanpaolo, pjesë e regjistrit të Grupeve Bankare.

Në Shqipëri, shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA, një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit Shqiptar, e licensuar si bankë e nivelit të dytë.

**Shoqëri Target:** Unione di Banche Italiane S.p.A., është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit italian, me objekt veprimtarie: Depozitim dhe kursimeve dhe ushtrimin e kredisë në format e ndryshme të saj, direkt dhe përmes filialeve, etj.

Unione di Banche Italiane S.p.A ka riorganizuar strukturën e saj të pronësisë së korporatave dhe si rrjedhojë ka modifikuar strukturën e saj duke siguruar mbulimin e tregut nëpërmjet rrjetit të shtatë bankave: Banca Popolare di Bergamo, Banco di Brescia, Banca Regionale Europea, Banca Commercio e Industria, Banca di Valle Camonica, Banca Popolare di Ancona, Banca Carime. Ky riorganizim i UBI Banca, ka kaluar në disa projekte të cilat kishin si qëllim bashkimin gradual të bankave pjesë e Unionit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i

kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**